



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4538 Prot.

Rrogozhinë, më 22.12.2023

## NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Mërkurë datë 27.12.2023 ora 10:00<sup>o</sup>**, me rendin e ditës si më poshtë :

- Miratim i rendit të ditës.
- Miratim i procesverbalit Nr.9, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 22.11.2023.
- 1- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 2- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e Paketës Fiskale viti 2024 për Bashkinë Rrogozhinë”.
- 4- Shqyrtim dhe miratim i Realizimit Faktik të Buxhetit 2023 të Bashkisë Rrogozhinë.
- 5- Shqyrtim dhe miratim i Relacionit të Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 për Bashkinë Rrogozhinë.
- 6- Shqyrtim dhe miratim i Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin në parim të dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 0.5 ha parcela nr.42/a, ZK.2824 më fshatin Okshtun, Njësia Administrative Lekaj dhe të sipërfaqes pyjore prej 0.65 ha parcela nr.51/a, ZK.3501 në fshatin Spille, Njësia Administrative Kryeviidh Bashkia Rrogozhinë”.
- 8- Shqyrtim dhe miratim i shkresës, “Kërkesa për të përfituar bursë nxënësit që vazhdojnë studimet në Institucionet e Arsimit të Mesëm Profesional për vitin shkollor 2023-2024” dhe Shtojcës po me këtë objekt kërkesë.
- 9- Shqyrtim dhe miratim i shkresës, “Kërkesa për të përfituar bursa sipas VKM Nr.666 datë 10.10.2019 për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar për vitin shkollor 2023-2024.

---


Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



- 10- Miratim i projekt-vendimit, "Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura".
- 11- Miratim i projekt-vendimit, "Për miratimin e Hartës së Plazhit Spille dhe Vilëbashtovë Bashkia Rrogozhinë në zbatim të VKM-së Nr.171, datë 27.03.2019, Për miratimin e Rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit".
- 12- Miratim i projekt-vendimit, "Për një ndryshim në VKB Nr.19 datë 19.09.2023 për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e strukturave komunitare në fshat".
- 13- Miratim i projekt-vendimit, "Mbi një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.8, datë 30.06.2023 'Për miratimin e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë".
- 14- Miratim i projekt-vendimit, "Për miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2024".
- 15- Shqyrtim kërkesa dhe raporte :
  - Shqyrtim i dhënies së titullit qytetar nderi, (Shqyrtohet po e njëjta kërkesë e vënë në dispozicion në mbledhjen paraardhëse të Këshillit Bashkiak), si dhe Relacioni i ardhur nga Sektori Juridik për këtë çështje.
  - Raport nga Administratori i Njesisë Administrative Sinaballaj, (Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen paraardhëse të Këshillit Bashkiak).
  - Raport, "Mbi vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak për periudhën Janar-Nëntor 2023, vendimet të cilat nuk janë konfirmuar ligjërisht nga Prefekti i Qarkut Tiranë, si dhe zbatueshmëria e këtyre vendimeve nga ana e administratës së Bashkisë".
- 16- Të ndryshme.

**Mbledhjet e Komisioneve të KB**, si më poshtë :

- **Njoftoj të mblidhet ditën e Martë datë 26.12.2023 ora 09 : 00<sup>oo</sup>, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit**, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Enver Memolla - Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej - Anëtar.
- **Njoftoj të mblidhet ditën e Martë datë 26.12.2023 ora 09 : 30<sup>oo</sup>, Komisioni i Urbanistikës, Zhvillimit Ekonomik dhe Infstrukturës**, me këtë përbërje : Shpati Kolgega - Kryetar, Saimir Cani - Zëvendëskryetar, Renato Kalemi - Anëtar, Gezime Met-hasani - Anëtare, Lije Dedej - Anëtare.
- **Njoftoj të mblidhet ditën e Martë datë 26.12.2023 ora 10 : 00<sup>oo</sup>, Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave**, me këtë përberje : Lulzim Hasa - Kryetar, Ferdi Avdiu - Zëvendëskryetar, Fatmira Thartori - Anëtare, Altin Tosku - Anëtar, Hekuran Xhani - Anëtar.
- **Njoftoj të mblidhet ditën e Martë datë 26.12.2023 ora 10 : 30<sup>oo</sup>, Komisioni i Shëndetsisë, Arsimit, Rinisë, Sportit, Kulturës dhe Turizmit**, me këtë përbërje : Sokol Gosa - Kryetar, Erind Tosku - Zëvendëskryetar, Renato Kalemi-Anëtar, Fatmira Thartori - Anëtare, Besnike Coraj - Anëtare.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

- Njoftoj të mblidhet ditën e Martë datë 26.12.2023 ora 11 : 00<sup>oo</sup>, Komisioni Juridike, Rend, Konflikte, me këtë përbërje : Mitat Daja - Kryetar, Indrit Dedej - Zv. Kryetar, Lulzim Hasa - Anëtar, Renato Kalemi - Anëtar.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Martë datë 26.12.2023 ora 11 : 30<sup>oo</sup>, Komisioni për Barazinë Gjinore dhe Përfshirjen Sociale, me këtë përbërje: Silvana Aliu - Kryetare, Fatmira Thartori - Zëvendëskryetare, Alime Hoxha - Anëtare, Fatbaradha Sina - Anëtare, Lije Dedej - Anëtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT  
ERIND TOSKU**

---

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com